Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV / Klasa: VIII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve	Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor): - emërton disa çrregullime në zhvillimin e organeve të tretjes, si dhe sëmundjet më të shpeshta të sistemit tretës.
<p>Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara):</p> <p>I.5. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.</p> <p>III.4. I parashtron pyetje vetes për çështjet që trajton dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare.</p> <p>V.2. Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjura nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.</p> <p>V.9. Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj.</p>	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Tipi i orës: Zhvillim	
Njësia mësimore: 2.9 Mbrojtja dhe sëmundjet e organeve të tretjes	
Fjalët kyçe: kapsllëk, diarre, ulcera e stomakut, <i>Helicobacter pylori</i> -i.	
<p>Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - numëron problemet më të shpeshta të sistemit tretës; - shpjegon mënyrat e parandalimit të problemet e aparatit gastrointestinal; - sqaron ku qëndron dallimi mes mospranimit të qumështit dhe alergjisë nga ai. <p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - emërto disa nga problemet më të shpeshta të sistemit tretës; - përshkruaj se çfarë çrregullimi është kapsllëku dhe diarreja; - sqaro se çfarë duhet të bëjmë, që të kemi stomak të shëndetshëm. 	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i klasës së 8, fotografi, CD me informacione nga interneti, slajde prezantuese të njësisë mësimore.	

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: TIK, Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrese: 10’T:- *Brainstorming* Gjatë kësaj faze mësimdhënësi/ja zhvillon me nxënësit/et në diskutim mbi njohuritë që ata kanë për Çrregullimet të sistemit tretës, bazuar në atë se çfarë ata kanë parë ose dëgjuar. Idetë e nxënësve plotësohen nga mësimdhënësi/ja.



Pjesa kryesore: 20’T: Veprimtari me lexim të drejtuar (VLD)

Mësimdhënësi/ja orienton nxënësit/et të lexojnë pjesën e parë të temës dhe të nxjerrin idetë e tyre.

Mësimdhënësi/ja drejton pyetjet:

- Cilat janë problemet më të shpeshta të sistemit tretës?
- Përshkruani se çfarë çrregullimi është kapsllëku dhe diarreja?
- Si mund t’i parandalojmë problemet e aparatit gastrointestinal?

Pasi merr përgjigjet për këto pyetje, mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit/et të lexojnë pjesën tjetër të temës,

Sëmundjet e tretjes gjatë adoleshencës, Problemet e aparatit tretës me qumështin

dhe të nxjerrin konkluzione. Pyetjet që do të drejtohen për këto pjesë do të ishin:

- Numëroni disa nga shkaqet paraqitjes së sëmundjeve të aparatit tretës te adoleshentët.
- Çfarë e shkakton sëmundjen e ulcerës së stomakut?
- Ku qëndron dallimi mes mospranimit të qumështit dhe alergjisë nga ai?
- Çfarë duhet të bëjmë që të kemi stomak të shëndetshëm?

Pjesa përfundimtare -10’T: Ditari dypjesësh

Mësimdhënësi/ja paraqet një tabelë, e cila plotësohet me pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve të klasës

Çrregullime të sistemit tretës	Sqarime
Kapsllëku	
Diarreja	
Ulcera e stomakut	

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm me listë kontrolli përmes kriterëve të suksesit, bashkëpunimin në grup, pjesëmarrja në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie: nxënësit/et individualisht grumbullojnë informacione nga burimet e tjera informuese rreth çrregullimeve të sistemit tretës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat natyrore Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV / Klasa: VIII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve	Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor): Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e zemrës dhe të enëve të gjakut, përkatësisht sistemin e organeve të qarkullimit të gjakut.
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.7 Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. IV.3 Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe të biodiversitetit, paraqet në formë të shkruar, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje, por edhe organizon ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit. V.2 Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjua nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla. Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësi mësimore: 2.10 Sistemi i organeve të qarkullimit të gjakut, zemra dhe enët e gjakut	
Fjalët kyçe: dhoma, barkushe, sistolë, diastolë, arterie, aortë, kapilarë, vena, gjaku.	
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore: Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e zemrës; Përkufizon konceptin sistolë dhe diastole; Tregon funksionin e qarkullimit të gjakut.	
Kriteret e suksesit: Përshkruaj se si ndërtohet dhe se si funksionon zemra. Tregon rëndësinë e qarkullimit të gjakut. Sqaro pse enët që furnizojnë zemrën janë shumë të rëndësishme për punën e saj. Përkufizo konceptin sistolë dhe diastolë. Tregon si klasifikohen e enët e gjakut.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri kl 8, fotografi, CD me informacione nga internet, slajde prezantuese të njësisë mësimore	


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: TIK, Gjuhë dhe komunikim, Kimi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa hyrese: 10’T:-Imagjinatë e drejtuar

Mësimdhënësi/ja në këtë faze të orës mësimore fillon duke vënë përpara nxënësve modelin e zemrës. Pyet nxënësit/et se çfarë ata dinë rreth zemrës. Pasi merr përgjigje i fton ata të shikojnë një video të shkurtër informuese rreth qarkullimit të gjakut dhe zemrës

<https://youtu.be/QG8VIJXfDFU>



Pjesa kryesore: 20’T: Leksion i avancuar

Pasi nxënësit/et kanë shikuar videon dhe kanë diskutuar në pika të shkurtra, mësimdhënësi/ja fillon të sqarojë në pika të shkurtra ndërtimin dhe funksionin e zemrës, sistemin e qarkullimit të gjakut ku gjatë sqarimeve përdorë slajde prezantuese, modele të zemrës, postiera të qarkullimit të gjakut etj. Më pas kërkon nga nxënësit/et të lexojnë njësinë mësimore.

Pjesa përfundimtare-10’T Ditari dypjesësh

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit/et që të plotësojnë shtyllat e tabelës.

Termat	Shpjegimet
Zemra	
Sistolë	
Diastolë	
Arterit	
Kapilarët	
Venat	
Gjaku	
Qarkullimi i vogël i gjakut	
Qarkullimi i madh i gjakut	

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim i vazhdueshëm me listë kontrolli përmes kriteve të suksesit, bashkëpunimin në grup, pjesëmarrja në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

P.sh. nxënësit/et individualisht grumbullojnë informacione nga burimet e tjera informuese rreth zemrës dhe sistemit të qarkullimit të gjakut.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor): Emërton dhe të përshkruan disa sëmundje të gjakut, të zemrës dhe të enëve të gjakut.
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): II.7 Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. IV.3 Analizon pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe të biodiversitetit, paraqet në formë të shkruar, apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit, mendimin dhe qëndrimin e vet për këtë çështje, por edhe organizon ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit. V.2 Argumenton nevojën e respektimit të regjimit për ushqyerje të shëndetshme dhe rekreacion ditor, javor apo mujor, sipas udhëzimeve të lexuara ose të dëgjura nga mjeku gjatë një diskutimi në klasë, në shkollë apo në familje.	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Tipi i orës: Zhvillim Njësia mësimore: Sëmundjet e zemrës, gjakut dhe enëve të gjakut	
Fjalët kyçe: sëmundje koronare, sulm në zemër, parandalim, trajtim	
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore: Emërto disa nga sëmundjet e zemrës; Përshkruan disa nga faktorët që rrisin rrezikun për të pasur sëmundje koronare të zemrës; Shpjegon masat parandaluese që duhet të ndërmerret njeriu për sëmundjet e zemrës.	
Kriteret e suksesit: Sqaro se çfarë rëndësie ka dieta dhe stili jetës në sëmundjet e zemrës. Trego disa nga masat parandaluese të sëmundjes së zemrës. Përshkruaj disa nga sëmundjet e zemrës.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 8 ,fotografi ,projektor, slajde për prezantim	

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore –Kimi, Tik

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Evokim(Pjesa hyrëse) 10 min.-Parashikimi me termat paraprak-
Mësimdhënësi/ja shkruan disa fjalë në tabelë: Duhanpirja, Dieta, Obeziteti, Sresi, Sulm në zemër

Drejton pyetjet:

- Çfarë përfaqësojnë termat e shkruar në tabelë?
- A mund të ndërtoni një paragraf ku të përdorni këta terma?

Nxënësit/et punojnë në dyshe duke diskutuar midis tyre dhe pas 10 minutash nxënësit/et lexojnë punimin e tyre lidhur me termat e dhënë.

Realizim/Pjesa kryesore-Lexim i drejtuar-Mësimdhënësi/ja kërkon nxënësve të lexojnë njësinë mësimore

“Sëmundjet e zemër” i cili lexim bëhet në pjesë. Nxënësve u shpërndan në grup fleta në cilën janë dhënë disa pika përmbledhëse dhe nga ta kërkon t’i plotësojnë ato pika.

Reflektim/Pjesa përfundimtare Rishikim në dyshe-

Detyrë në çifte. Dy nxënësit/et e çdo çifti, mësimdhënësi/ja i emërton A dhe B.

Kur nxënësi/ja A komenton pikat kryesore të mësimi, nxënësi/ja B i dëgjon ato. Pastaj dy nxënësit/et ndërrojnë rolet midis tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie; vlerësim i ndërsjellë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit/et hulumtojnë nga burimet tjera informuese për sëmundjet e zemrës

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORES MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Përshkruan si kryhet transfuzioni i gjakut dhe si caktohen grupet e gjakut të sistemit ABO.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.1 Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara. IV.2 Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instalacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin. VI.3 Shpreh solidaritet me personat në nevojë ose të rrezikuar, duke ndërmarrë veprime/aksione konkrete për ofrimin e ndihmës sipas nevojës që kanë.	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Tipi i orës: Zhvillim	
Njësia mësimore: 2.13 Transfuzioni i gjakut dhe grupet e gjakut të sistemit ABO	
Fjalët kyçe: glikoproteinike, aglutinogjene, grupi O, grupi A, grupi AB, grupi B, aglutinim, faktori rrezus (Rh).	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Numëron grupet e gjakut; - Shpjegon rregullat e transfuzionit të gjakut; - Tregon se cilat janë dy lëndët proteinike të quajtura aglutinina. - Kriteret e suksesit: - Sqaro se si ndodh dukuria e aglutinimit. - Emërto grupet e gjakut. - Parashiko cilat grupe janë të përshtatshme për t'i dhuruar gjak një njeriu me grupin A. 	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore –Kimi, Tik	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Njësia mësimore realizohet përmes teknikës: **Di, Dua të di, Mësova**

Evokim (Pjesa hyrëse-) 10min-Di

Në kolonën di mësimdhënësi/ja rekomandon nxënësit/et të shkruajnë atë çfarë dinë rreth njësive mësimore duke u bazuar në atë që dinë nga njohuritë paraprake.


Realizim/Pjesa kryesore 20 min-Dua të di-

Nxënësit/et lexojnë njësinë mësimore në libër dhe më pas parashtrojnë pyetje për atë që duan të dinë

DI	DUA TË DI	MËSOVA
	Cilat janë grupet e gjakut?	
	Si ndodh dukuria e aglutinimit?	
	Parashikoni cilat grupe janë të përshtatshme për t'i dhuruar gjak një njeriu me grupin A.	
	Çka është faktori rrezus (Rh).	
	Sa lloje aglutinogjene ekzistojnë dhe cilat janë ato?	

Reflektim/Pjesa përfundimtare-10mi - Mësova

Gjatë plotësimit të kolonës mësova mësimdhënësi/ja ekspozon disa foto ku nga nxënësit/et kërkohet t'i komentojnë ato. Në kolonën mësova shkruajnë ato që mësuuan.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie; vlerësim i ndërsjellë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit/et hulumtojnë nga burimet e tjera informuese për grupet e gjakut.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORES MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyres Lënda: Biologji Shkalla e kurrikules: IV Klasa: VII	
<p>Tema (nga planidymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve të shtazët</p>	<p>Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor): Përshkruan mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore, branshiale dhe trakeidale si dhe rregullimin e saj. Krahason këmbimin e gazrave në alveole dhe në qelizë.</p>
<p>Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2 Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II.1 Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara. V.9 Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj.</p>	
<p>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla</p>	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
<p>Tipi i orës: Zhvillim</p> <p>Njësia mësimore: 2.16 Procesi i frymëmarrjes</p>	
<p>Fjalët kyçe: oksigjeni, dioksidi i karbonit, shkëmbimi i gazeve, alveolat,</p>	
<p>Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërton gazet që shkëmbehen në alveola; - Definon termin ajmërim të mushkërive; - Shpjegon rolin që ka veshja me qime (me qerpikë) e rrugëve të frymëmarrjes. <p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruaj rrugëtimin e një molekule oksigjeni nga çasti kur thithet nëpërmjet hundës, deri në momentin kur mbërrin në gjak. - Sqaron ku kryhet shkëmbimi i gazrave. - Trego se çfarë kuptoni me ajrim të mushkërive. 	
<p>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 8 ,fotografi ,projektor, sllajde për prezantim</p>	
<p>Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore –Kimi, Tik</p>	

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Evokim (Pjesa hyrëse-)10min- MINI MËSIM

Mësimdhënësi/ja para nxënësve paraqet disa fotografi ku kërkon nga ata/ato t'i vështrojnë me kujdes dhe të japin komentin e tyre rreth fotografive.



Diskutohen të gjitha mendimet e nxënësve.

Realizim (Pjesa kryesore) 20 min- DITARI DYPJESËSH

Pasi nxënësit/et të reflektojnë mbi atë që shikuan bashkarisht përmes fotografive arrijnë të zbulojnë se për çfarë do të mësojnë sot si-Procesi i frymëmarrjes. Pastaj mësimdhënësi/ja jep disa sqarime të shkurtëra lidhur me temën. Në vazhdim udhëzon nxënësit/et që të hapin librat dhe të fillojnë të lexojnë informacionet nga libri, ndërkohë pas leximit në heshtje i udhëzon ata që të punojnë një ditarë dypjesësh duke nxjerr citate dhe përshkruar ato. Pastaj nga secili grup nga një përfaqësues do t'i lexojë dhe komentojë ato çfarë kanë shënuar. Si do dukej një tabelë e ditarit dypjesësh:

<i>Procesi i frymëmarrjes</i>	<i>Sqarimet</i>
<i>Një fëmijë i posalindur</i>	<i>Merr frymë rreth 60 herë në minutë</i>
<i>Korda zanore</i>	
<i>Shkëmbimi i gazrave</i>	
<i>Ajrim të mushkërive</i>	

Reflektim(Pjesa përfundimtar)e-10min –DISKUTIM

Mësimdhënësi/ja fton nxënësit/et të dikutojnë rreth pyetjeve si:

1. Cilat janë gazet që shkëmbehen në hojëza?
2. Çfarë roli ka veshja me qime (me qerpikë) e rrugëve të frymëmarrjes?
3. Çfarë kuptoni me ajrim të mushkërive?
4. Përshkruani rrugëtimin e një molekule oksigjeni nga çasti kur thithet nëpërmjet hundës, deri në momentin kur mbërrin në gjak.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie;vlerësim i ndersjelltë, informate kthyese

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit/et hulumtojnë nga burimet e tjera informuese për procesin e frymëmarrjes.

Reflektimi për rrjedhën e ores mësimore

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VII	
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët	Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Emërton disa sëmundje që barten nëpërmjet të ajrit dhe vlerëson pasojat e pirjes së duhanit dhe ajrit të ndotur për rrugët e frymëmarrjes. Përshkruan si kryhet masazhi i zemrës, frymëmarrja artificiale dhe reanimimi.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2 Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II.1 Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara. V.9 Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj.	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Tipi i orës: Zhvillim Njësia mësimore: 2.18 Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	
Fjalët kyçe: astma, bronkiti, pneumonia, gypat e bronkiolve.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Numëron disa nga shkaktarët e sëmundjeve në aparatit të frymëshkëmbimit; - Emërton sëmundjet më të shpeshta të aparatit të frymëshkëmbimit; - Përshkruan se si kryhet masazhi i zemrës, frymëmarrjes artificial dhe reanimimi. <ul style="list-style-type: none"> - Kriteret e suksesit: - Përshkruaj shkaktarët e sëmundjeve të frymëmarrjes. - Emërto sëmundjet më të shpeshta në rrugët e frymëmarrjes. - Sqaro rëndësinë e dhënies së ndihmës së parë. 	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore –Kimi, Fizikë	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	

Evokim (Pjesa hyrëse) 10 min.- SHKRIM I LIRË

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit/et të shkruajnë një shkrim të shkurtër rreth asaj se çka dinë për sëmundjet e frymëmarrjes. Mësimdhënësi/ja i orienton nxënësit/et duke u përmendur ndonjë sëmundje të frymëmarrjes si p.sh. bronhitisi, astma etj. Pasi nxënësit/et t'i kenë shënuar shkrimet, ftohen disa nxënës/e t'i lexojnë shkrimet e tyre dhe diskutohen bashkarish.

Realizim(Pjesa kryesore) 20 min.- MINI LEKSION

Mësimdhënësi/ja fton nxënësit/et t'i shikojnë një video të shkurtër dhe disa fotografi të sëmundjeve të frymëmarrjes. Pasi t'i kenë shikuar fotot dhe videon kërkon nga nxënësit/et t'i komentojnë ato. Më pas, mësimdhënësi/ja jep sqarime rreth njësisë mësimore si problemet më të shpeshta të rrugëve të frymëmarrjes, rëndësia e dhënies së ndihmës së parë etj.

<https://youtu.be/spXcYQXGgul>



Astma

Reflektim (Pjesa përfundimtar)e-10min-DISKUTIM

Mësimdhënësi/ja shënon disa pyetje në tabelë, ndërsa nxënësit/et diskutojnë në grup rreth përgjigjeve dhe përfaqësuesit e grupit komentojnë përgjigjet. Disa nga pyetjet e mundshme janë këto si:

- Numëroni disa nga shkaktarët e sëmundjeve në aparatit të frymëshkëmbimit.
- Cilat janë sëmundjet më të shpeshta të aparatit të frymëshkëmbimit?
- Sqaro rëndësinë e dhënies së ndihmës së parë?
- Analizo dhënien e ndihmës së parë të grup moshat e ndryshme?
- Ku ndryshon ndihma e parë te të rriturit me atë te fëmijët apo foshnjat?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësim për nxënie;Vlerësim i ndërsjellë;Informate kthye.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Nxënësit/et hulumtojnë nga burimet e tjera informuese për sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORES MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Emërton dhe shpjegon indin nervor, organet dhe sistemin e organeve nervore. Analizon evolucionin e sistemit nervor te shtazët.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. III.6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj. IV.1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 2.24 Indi nervor, organet dhe sistemi i organeve nervore			
Fjalët kyçe: sistem nervor, truri, palca kurrizore, sistem nervor qendror, sistem nervor periferik, neurone.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - identifikon katër pjesët kryesore të një neuroni; - përshkruan funksionin e secilës prej pesë pjesëve kryesore të trurit; - krahason veprimet e qelize ndijore dhe qelizave nervore motorike. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Sqaro funksionin e aksoneve dhe mielines. - Identifikon pjesët e trurit. - Trego funksionin e neuroneve ndjesore dhe atyre motorike. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Pyetja sjell pyetjen

Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke lënë nxënësit/et të supozojnë se njëri prej tyre pa një kartëmonedhë në dysheme. Ai përkulet dhe e merr atë. Më pas, fillohet me pyetje.

•Pse ndodhi kështu?

(Përgjigja e pritshme: Kjo është për shkak të sistemit tonë nervor)

Informojini se organet e tyre shqisore dërgojnë informacion në trurin e tyre gjatë gjithë kohës.

Tani bëni pyetjet e mëposhtme:

Si e di truri juaj për paratë?

Cili receptor ju informon për praninë e kartëmonedhës?




Cila pjesë e trupit

tuaj e prodhoi këtë përgjigje?

Informoni nxënësit/et se receptorët në sytë e tyre dërgojnë informacion në trurin e tyre. Ky quhet impuls nervor. Sistemi nervor qendror (CNS) vendos veprimin dhe muskujt në krahun e tyre prodhojnë lëvizjen e nevojshme për të marrë kartëmonedhën.

Përgjigjuni kartave

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit/et ndahen në grupe dhe më pas shpërndahen disa nga kartat e krijuara më parë nga ana e mësimdhënësit/es. Në karta janë disa pyetje rreth njësisë së re mësimore, për të cilat nxënësit/et do të përgjigjen. Nxënësit/et udhëzohen që të lexojnë njësinë mësimore e më pas të përgjigjen.

 <p>Cilat janë pjesët ndërtuese të neuronit?</p>	<p>Tregoni llojet e neuroneve dhe sqaro funksionin e tyre?</p> 	 <p>Tregoni ku dallon truri i kurrizorëve nga truri i organizmave të tjerë.</p>
<p>Si ndahet sistemi nervor?</p>	<p>Sqaroni funksionet e pjesëve ndërtuese të trupit.</p>	<p>Shpjegoni, pse e tërheqim dorën kur prekim diçka të nxehtë.</p>

Diskutim

Në fund të orës mësimore, nxënësit/et fillojnë me diskutimin e përgjigjeve. Nëse njëri grup nuk është përgjigjur si duhet, kërkohet nga grupit tjetër që të përgjigjen. Nëse është e nevojshme, ndërhyt edhe mësimdhënësi/ja me sqarime shtesë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të shënohet figura e neuronit me pjesët e tij ndërtuese

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Emërton dhe shpjegon indin nervor, organet dhe sistemin e organeve nervore. Analizon evolucionin e sistemit nervor te shtazët.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. III.6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj. IV.1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 2.25 Funksionimi i sistemit nervor			
Fjalët kyçe: sistem nervor, truri, ganglione, palca kurrizore, pakurriozret, kurrizore			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan funksionin e sistemit nervor; - krahason sistemin nervor te kurrizoreve nga ai i pakurriozre; - shpjegon zhvillimin evolutiv te sistemit nervor. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Emërto nga figura pjesët ndërtuese të sistemit nervor. - Sqaro ndërtimin e sistemit nervor te yllit te detit dhe insekteve. - Analizo sistemin nervor te kurrizoret. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit/et që të mendojnë se çfarë dinë mbi funksionimin e sistemit nervor. Më pas ndahet klasa në 6 grupe dhe u shpërndahen fletë të bardha. Kërkohet prej tyre të shënojnë nga një term që ka ndërlidhje me funksionimin e sistemit nervor. Nxënësit/et nuk shënojnë emrin e tyre dhe pasi të kenë shënuar termin, ata duhet të bartin fletën te shoku apo shoqja e grupit. Në fund, fleta dorëzohet te mësimdhënësi/ja dhe qëndron që të diskutohet në fund të orës mësimore.

Kubimi

Për secilin grup parashtrohet nga një pyetje e cila ndodhet në njërin nga faqet e kubit.

1. Cili është funksioni i sistemit nervor?
2. Cila është njësia bazë e ndërtimit dhe e funksionit të sistemit nervor?
3. Ku qëndron dallimi midis sistemit nervor të pakurrizorëve dhe atij të kurrizorëve?
4. Sipas jush, pse molusqet grabitqare kanë një sistem nervor më të zhvilluar se molusqet që bëjnë jetë të ngadalshme?

Diskutim

Në pjesën e fundit të orës mësimore, mësimdhënësi/ja hap fletat, të cilat nxënësit/et i kanë plotësuar në fillim të orës mësimore. Nxënësit/et fillojnë dhe diskutojnë për ato të cilat janë shënuar dhe në të njëjtën kohë shohin a janë dhënë termat e duhur.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtohet rreth substancave që dëmtojnë sistemin nervor.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët		Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor): Emërton dhe shpjegon indin nervor, organet dhe sistemin e organeve nervore. Analizon evolucionin e sistemit nervor te shtazët.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. III.6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj. IV.1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 2.26 Funksioni i sistemit nervor- Feedback negativ			
Fjalët kyçe: sistem nervor, neuronet ndjesore, neuronet lëvizore, neurotransmetues, sinapsa, pjesa parasinaptike, pjesa pasinsinaptike.			
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan pjesët përbërëse të sinapsës; - rendit ngjarjet e një refleksi; - shpjegon funksionin e neurotransmetuesve. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Emërto nga figura pjesët ndërtuese të sinapsës. - Jep një shembull të mënyrës së funksionimit të refleksit. - Trego kush mund të shërbejë si neurotransmetues. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit/et që të mendojnë se çfarë dinë mbi funksionimin e sistemit nervor. Më pas ndahet klasa në 6 grupe dhe u shpërndahen fletë të bardhë. Kërkohet prej tyre të shënojnë nga një term që ka ndërlidhje me funksionimin e sistemit nervor. Nxënësit/et nuk shënojnë emrin e tyre dhe pasi të kenë shënuar termin, ata/ato duhet të bartin fletën te shoku apo shoqja e grupit. Në fund, fleta dorëzohet te mësimdhënësi/ja dhe qëndron që të diskutohet në fund të orës mësimore.

Kubimi

Për secilin grup parashtrohet nga një pyetje e cila ndodhet në njërin nga faqet e kubit.

Përshkruani tri llojet e neuroneve.

Shpjegoni rrugën e harkut reflektiv.

Emërtoni pjesët ndërtuese të sinapsës.

Skiconi grafikun e paraqitur në tekst.

Vlerësoni rëndësinë e funksionimit të sinapseve.

Diskutim

Në pjesën e fundit të orës mësimore, mësimdhënësi/ja hap fletat, të cilat nxënësit/et i kanë plotësuar në fillim të orës mësimore. Nxënësit/et fillojnë dhe diskutojnë për ato të cilat janë shënuar dhe në të njëjtën kohë shohin a janë dhënë termat e duhur.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtohet rreth substancave që dëmtojnë sistemin nervor.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te shtazët		Rezultati i të nxënimit të temës (nga plani dymujor): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët, bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.	
Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4. Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit. II.1 Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara. III.3. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 2.27 Shqisat antena të trupit tonë, organet e të parit dhe të dëgjuarit			
Fjalët kyçe: shqisa, syri, veshi, receptorë, impuls nervor, impuls elektrik.			
Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruani strukturat kryesore të pranishme në secilën nga tri shtresat e syrit; - përshkruani strukturat kryesore në veshin e jashtëm, veshin e mesëm dhe veshin e brendshëm; - diskutoni funksionet kryesore të këtyre strukturave. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Trego pjesët ndërruese të të parit dhe të të dëgjuarit. - Sqaro si funksionon të dëgjuarit. - Sqaro si funksionon të parit. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pyetje dhe diskutim


Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke diskutuar me nxënësit/et rreth njësisë së re.

Cilat janë shqisat tona? Si funksionojnë ato?

Shqisat tona janë një mënyrë jetike për të mësuar dhe kuptuar botën tonë. Çdo sekondë, trupat tanë marrim sasi të mëdha informacioni nga mjedisi ynë - informacion për të cilin truri ynë ka nevojë përpunojmë dhe përgjigjemi në mënyrë që ne të mbijetojmë. Janë pesë shqisa të njohura tradicionalisht që na ndihmoni të mbledhim të gjithë këtë informacion - shikimin, dëgjimin, shijen, prekjen dhe nuhatjen. Pas diskutimit, mësimdhënësi/ja ndan klasën në grupe. Secilit prej grupeve, mësimdhënësi/ja u jep nga një pasqyrë. Kërkohej prej tyre të tregojnë se çfarë shohin. Udhëzohen nxënësit/et të shikojnë syri dhe veshin. Nxiten të diskutojnë për pjesët e këtyre shqisave që shohin.

Organizues grafik

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit/et të fillojnë të lexojnë njësinë mësimore dhe ashtu siç janë, në grupe të tregojnë funksionet e pjesëve ndërtuese të syrit dhe veshit.



Diskutim

Në fund të orës mësimore, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe sqaron ndërtimin strukturor të syrit dhe veshit.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrës në diskutime;
- plotësimin e grafikës;
- sqarim të duhur të pjesëve ndërtuese të syrit dhe veshit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtohen mënyrat e të parit dhe të dëgjuarit tek organizmat e ndryshëm.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkenca e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve		Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani dymujor): Përshkruan sistemin e organeve riproduktive të bimëve.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II.7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. III.7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënësve të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 3.8 Riprodhimi të bimëve			
Fjalët kyçe: rrënja, kërcelli, bimët njëthelbore, bimët dythelbore, rrënjë mitake, rrënjë boshtore, rrënjë xhufkore.			
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: - tregon mënyrat e riprodhimit të bimëve; - dallon sistemin rrënjor, boshtor dhe xhufkor; - arsyeton rëndësinë e rrënjës për bimën.			
Kriteret e suksesit: - Identifikoj kërcellin e bimës njëthelbore dhe dythelbore. - Përshkruaj ndërtimin e sistemit rrënjor boshtor dhe xhufkor. - Sqaro funksionin e rrënjës për bimën.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, hamer, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkenca natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Imagjinatë e drejtuar

Mësimdhënësi/ja paraqet foto të deles *Dolly*, patate, amebës, hidrës, baktere që ndahen në dysh. Kërkoheq që nxënësit/et të shikojnë me vëmendje foton e paraqitur dhe më pas pyeten rreth asaj se çfarë kanë të përbashkët të gjitha këto foto.

Shpjegoni se klonimi me të vërtetë ndodh natyrshëm te bimët. Bimët mund të riprodhohen në mënyrë aseksuale (duke prodhuar klone) ose seksualisht (duke prodhuar fara). Klonimi është më pak i zakonshëm te kafshët, megjithëse binjakët identikë janë klone njerëzore.



DRTA

Kërkoheq nga nxënësit/et që të lexojnë njësinë mësimore *Riprodhimi te bimët*, pastaj u parashtrohet pyetje.

Cilat janë llojet e riprodhimit te bimët? Sqaroni si ndodh riprodhimi seksual. Tregoni përparësitë e riprodhimit seksual dhe aseksual te bimët. Analizoni ndryshimet gjenetike që ndodhin gjatë riprodhimit seksual.

Më pas vazhdoheq me diskutimin e përgjigjeve. Mësimdhënësi/ja vëzhgon vazhdueshëm dhe dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve, nëse është e nevojshme jep sqarime shtesë.

Rrjet i diskutimeve

Klasa ndahet në dy grupe ku njëri grup do të tregojë rreth riprodhimit seksual ndërsa grupi tjetër për riprodhimin joseksual të bimëve. Të dy grupet të paraqesin avantazhet dhe disavantazhet e riprodhimit përkatës dhe diskutojnë rreth tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtohet se cilat bimë riprodhohen në mënyrë seksuale dhe ato që shumohen në mënyrë aseksuale.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Identifikon dallimet thelbësore sa i përket ndërtimit të lules së bimëve farëzhveshura dhe farëveshura.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.5. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik. III.7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta. IV.1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 3.9 Bimët farëveshura dhe farëzhveshura			
Fjalët kyçe: bimët farëveshura, bimë farëzhveshura, farë, boça, lule.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan tiparet e bimëve farëzhveshura; - sqaron ndërtimin e bocave mashkullore dhe femërore; - sqaroni funksionet e pjesëve ndërtuese të lules te bimët farëveshura. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Listo karakteristikat e bimëve farëzhveshura. - Analizo strukturën e bocave femërore dhe mashkullore te bimëve farëzhveshura. - Analizo strukturën e lules te bimët farëveshura. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, hamer, bimë, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Kllaster

Orën mësimore, mësimdhënësi/ja e fillon me pyetje rreth njësisë së re mësimore. Pyeten nxënësit/et se çfarë dinë për bimët farëveshura dhe farëzhveshura. Të gjitha mendimet e nxënësve shënohen në tabelë pa i komentuar ato.

Tabela e koncepteve

Kërkohet nga nxënësit/et që të lexojnë njësinë mësimore dhe më pas të plotësojnë tabelën e dhënë. Në njëërën kolonë të tabelës shënohen konceptet kryesore të njësisë mësimore, ndërsa në kolonën tjetër shënohen sqarimet e atyre koncepteve.

Konceptet	Sqarimet
Cilat janë tiparet e grupit të bimëve farëveshur?	
Tregoni tiparet.	
Sqaroni ndërtimi e bocave femërore te bimët farëzhveshura.	
Sqaroni ndërtimin e bocave mashkullore te bimët farëzhveshura.	
Shpjegoni ndërtimin e lules te bimët farëveshura.	

Pasi të kenë mbaruar leximin dhe punimin e tabelës, ftohen nxënësit/et të diskutojnë për përgjigjet e tyre. Mësimdhënësi/ja, së pari, fton nxënësit/et të cilët janë më të tërhequr gjatë diskutimeve, në mënyrë që edhe ata të jenë pjesë aktive e orës mësimore.

Në fund të orës mësimore, mësimdhënësi/ja shënon një pyetje me të cilën vazhdohet diskutimi në klasë:
Si mendoni, pse fara e bën të mundur riprodhimin e bimëve pa praninë e ujit?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kërkohet nga nxënësit/et të vizatojnë dhe të etiketojnë pjesët ndërtuese të lules.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shken- cat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Analizon dallimet bazë mes bimëve monokotiledone dhe dikotiledone.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II.7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. III.7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 3.10 Bimët monokotiledone dhe dikotiledone			
Fjalët kyçe: monokotiledone, dikotiledone, farë, gjethe, kërcell, rrënjë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: - krahason ndryshimet midis bimëve një dhe dythelbore; - tregon disa përfaqësues të bimëve një dhe dythelbore.			
Kriteret e suksesit: - Analizo ndërtimin strukturore të bimëve një dhe dythelbore. - Listo disa bimë një dhe dythelbore.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, hamer, projektor, slajde për prezantim, fara të bimëve të ndryshme.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Imagjinatë e drejtuar Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke paraqitur para nxënësve disa foto. Më pas, pyeten nxënësit/et nëse u pëlqejnë qepët, orizi, bananet, patatet, fasulet, domatet etj. Sqarohet se këto janë bimë të cilat bëjnë pjesë te bimët mono dhe dikotiledone.			

Lexim i drejtuar

Nxënësit/et ndahen në grupe dhe hapen librat te njësia e re mësimore. Para çdo grupi të nxënësve shpërndahen pjesë të ndryshme të bimës, të cilat do të vëzhgohen nga ana e tyre.

Para tyre shpërndahen disa fara të bimëve të misrit, fasules. Kërkohet të vëzhgojnë me kujdes strukturën e jashtme të farave dhe të shënojnë dallimet e tyre në fletore. Mund të kërkohet të hiqet shtresa e jashtëm e farës.

Ndërkohë, mësimdhënësi/ja jep sqarime e nevojshme për njësinë. Tregohet që kotiledonet gjenden në të gjitha farat, disa bimë prodhojnë fara me një kotiledon dhe quhet bime njëkotiledone, ndërsa disa bimë prodhojnë fara me dy kotiledone dhe quhen bimë dykotiledone.

Gjithashtu, kërkohet të vëzhgohen edhe format dhe degëzimet e gjetheve të bimëve të sjella. Pas vëzhgimit, nxënësit/et shkruajnë në fletore dallimet.

Diskutim

Nxënësit/et diskutojnë vëzhgimet e tyre dhe në të njëjtën kohë shënojnë dallimet mes bimëve një- dhe dythelbore në tabelën e mëposhtme.

Njëthelboret	Dythelboret
Fara me një kotiledon	Fara me dykotiledone
Venat paralele në gjethe	

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- plotësimin e tabelës;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përgjigjuni pyetjeve në libër, faqe 144.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Definon dhe shpjegon termat polenizim dhe frytnim.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II.7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. III.7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 3.11 Pjalmimi dhe pllenimi			
Fjalët kyçe: bime, pjalmim, polenizim, vetëpjalmim, pjalmimi i kryqëzuar, insekte.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: - përkufizon termin pjalmim dhe pllenimin; - dallon vetëpjalmimin nga pjalmimi i kryqëzuar; - përshkruan si zhvillohet pllenimi ne lulen e bimës.			
Kriteret e suksesit: - Përshkruaj procesin e pjalmimit dhe polenizimit. - Jep shembull te bimëve te cilat kryejnë procesin e vetëpjalmimit dhe te pjalmimit te kryqëzuar. - Analizo si krijohet pllenimi.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, hamer, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Tregojuni nxënësve lulet (ose figurat) të ndryshme që keni mbledhur. Pyetini se cila është e preferuara e tyre.			

Kërkoni nga nxënësit/et të shkruajnë një paragraf në fletoren e tyre (ose pajisjen elektronike) rreth lules se tyre te preferuar duke shënuar edhe arsyet.

U thoni atyre të jenë të përgatitur për të ndarë shkrimet e tyre me klasën. Disa nga nxënësit/et lexojnë shënimet e tyre.

Shpjegojuni nxënësve se ashtu si ata/ato preferojnë disa lule mbi të tjerat, ashtu bëjnë edhe pjalmuesit. Për shembull, për shkak se një flutur ka një pjesë të gjatë dhe të hollë të gojës (*proboscis*), ata preferojnë lule që janë të gjata dhe të ngjashme me tuba. Disa miza, nga ana tjetër, kanë pjesë të shkurtra dhe të rrumbullakëta të gojës si sfungjer. Për këta pjalmues preferohet një lule e hapur. Ose, për pjalmuesit e tjerë, si p.sh.

tenja, preferohet një lule që është e hapur gjatë natës, sepse atëherë janë aktive tenja. Japin sqarimet e duhura rreth procesit të pjalmimit dhe pllenimit.

Shfaq videon se si zhvillohet pjalmimi

<https://youtu.be/iE8eMLbuEJs>

Çfarë dini tashmë për mënyrën se si bimët riprodhohen?

• Hapi i parë vendimtar për shumicën e riprodhimit të bimëve është pllenimi.

Pasi bletët dhe insektet marrin pa dashje polenin, kur fluturojnë në një lule tjetër, çfarë ndodh?

• Tregojuni nxënësve një lule e mbledhura nga oborri i shkollës tuaj. Vazhdoni diskutimin me pyetjet:

Cilat pjesë mendoni janë meshkuj?

Cilat pjesë mendoni se janë femra?


Më pas, vazhdoni me sqarimet e duhura rreth pjalmimit.

Merrni pjalmën nga anteria e njëres lule dhe vendoseni mbi stigmën e lules tjetër.

• Si mendoni se sperma në polen mund të fekundojë vezën, e cila është e përmbajtur në ovulë?

• Kur poleni, i cili përmban gametët (spermatozoidet) mashkullorë ulet stigma, ajo udhëton poshtë tubit të polenit deri në ovulë, ku ajo fekondon gametët (vezët) femërore. Vezët e fekunduara tani bëhen fara(et) dhe vezoret bëhen fruti. Zbërtheni lulen dhe tregojuni nxënësve shtegun ku kalon poleni.

Nxënësve u shpërndahen foto.



Kërkoni nxënësve të gjurmojnë rrugën e polenit dhe të etiketojnë se ku ndodh fekondimi në diagramet e tyre.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtohet rreth krijimit të farës dhe frytit.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Shpjegon si formohet fryti dhe fara dhe dallon llojet e fryteve e farave. Shpjegon rëndësinë e frytnimit artificial për fisnikërimin e bimëve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II.7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 3.12 Fryti dhe fara. Frytëzimi artificial			
Fjalët kyçe: fara, fryti, shartim, ovul, bimë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan ndërtimin e farës; - tregon llojet e fryteve; - sqaron frytëzimin artificial. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Sqaro funksionet e pjesëve të farës. - Krahaso ndërtimin e llojeve të ndryshme të fryteve. - Analizo procesin e shartimit. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, hamer, projektor, slajde për prezantim, fara të bimëve të ndryshme.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Stuhi mendimesh			
Mësimdhënësi/ja prezanton klasën me farat duke treguar farat e misrit dhe të sojës. Pyetini nxënësit/et se çfarë janë ato dhe pse mund të jenë të rëndësishme. Kërkojuni të listojnë disa shembuj artikujsh që përmbajnë misër dhe sojë.			
Etanol, vaj vegjetal, karamele, sedilje makinash, qilim, lista mund të vazhdojë! Të gjitha mendimet shënohen në tabelë dhe nuk komentohen.			

Lexim i drejtuar

Kërkohet nga nxënësit/et të lexojnë njësinë e re mësimore. Ndahet klasa në grupe dhe më pas, jepini secilit grup një farë misri dhe një farë sojë.

U thoni nxënësve të kërkojnë pjesë të farës. Gjatë kësaj kohe, paraqitni foto me të gjitha pjesët ndërtuese të farës në tabelë ose në ekranin e projektorit. Nxitini nxënësit/et të kërkojnë sa më shumë pjesë që të mundën.

Udhëzoni nxënësit/et të vizatojnë diagrame të farave të tyre në fletore dhe të etiketojnë pjesët që mund të shohin. Në të njëjtën kohë kërkohet që nxënësit/et t'iu përgjigjen edhe disa pyetjeve të cilat mësimdhënësi/ja i paraqet në projektor ose shënohen në tabelë. *Cilat janë llojet e fryteve? Pse është i rëndësishëm shartimi?*

Rrjeti i diskutimit

Ftohen nxënësit/et të diskutojnë rreth njësisë së re mësimore, konkretisht rreth përgjigjeve të pyetjeve të mëparshme. Nëse është e mundur, lërin nxënësit/et të hanë disa fara! Keni në dispozicion misër, sojë, luledielli, fara kungulli, kikirikë, qiçra ose fara të tjera.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtohet në internet rreth faktorëve dhe mënyrës së mbirjes së farës.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve te bimët		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Emërton disa lloje bimore sipas vlerave përdoruese: ushqim, mjekësi, ekonomi etj.	
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):</p> <p>I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.</p> <p>II.7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.</p> <p>III.7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.</p>			
<p>Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):</p> <p>Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve te njeriu, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.</p>			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 3.13 Rëndësia e bimëve në jetën e përditshme			
Fjalët kyçe: bimët, njeriu, fotosinteza, të ushqyerit, barnat, veshje.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan rolin e bimëve në jetën e njeriut; - trego procesin e fotosintezës. 			
<p>Kriteret e suksesit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jep shembull të rolit të bimëve për jetën e njeriut. - Shpjego rëndësinë e fotosintezës. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, hamer, projektor, slajde për prezantim, fara të bimëve të ndryshme.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
<p>Ora mësimore fillon duke u bërë pyetje si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat janë disa gjëra që na sigurojnë bimët? 2. Pse mendoni se bimët janë të rëndësishme? <p>Diskutoni shkurt përgjigjet e nxënësve, duke theksuar rëndësinë e bimëve në jetën tonë të përditshme.</p> <p>II. Bimët dhe oksigjeni</p> <p>A. Paraqitni mjete ndihmëse vizuale ose përdorni slajde në PowerPoint për të shpjeguar procesin e fotosintezës.</p>			

B. Shpjegoni se si bimët prodhojnë oksigjen si nënprodukt të fotosintezës.

C. Theksoni se oksigjeni është thelbësor për të gjithë organizmat e gjallë, duke përfshirë njerëzit.



III. Prodhimi i ushqimit

A. Diskutoni rëndësinë e bimëve si burim kryesor i ushqimit për njerëzit dhe kafshët.

B. Tregoni imazhe ose mostra të llojeve të ndryshme të bimëve që konsumojmë (fruta, perime, drithëra, etj.).

C. Shpjegoni rëndësinë e një diete të ekuilibruar që përfshin ushqime me bazë bimore për një mënyrë jetese të shëndetshme.

D. Diskutoni ndikimin e sëmundjeve të bimëve dhe rëndësinë e ruajtjes së bimëve për sigurinë ushqimore.

IV. Rëndësia ekologjike

A. Shpjegoni rolin e bimëve në ruajtjen e ekuilibrit të ekosistemeve.

B. Diskutoni procesin e transpirimit dhe mënyrën se si bimët ndihmojnë në rregullimin e ciklit të ujit.

C. Theksoni rëndësinë e bimëve në sigurimin e habitateve për organizmat e tjerë.

D. Diskutoni ndikimin e shpyllëzimit dhe nevojën për ripyllëzim dhe përpjekje për ruajtjen.

V. Përfitimet Mjedisore

A. Shpjegoni se si bimët ndihmojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike duke thithur dioksidin e karbonit (CO2) nëpërmjet fotosintezës.

B. Diskutoni rolin e bimëve në reduktimin e ndotjes së ajrit duke thithur gazra dhe grimca të dëmshme.

C. Shpjegoni se si bimët ndihmojnë në parandalimin e erozionit të tokës dhe përmirësojnë cilësinë e tokës nëpërmjet rrënjëve të tyre.

Aktiviteti ndërveprues: Fakte mbi bimët

A. Shpërndani kartat ose fletë të vogla letre për secilin nxënës.

B. Udhëzoni nxënësit/et të shkruajnë një fakt interesant rreth bimëve.

C. Mblidhni kartat dhe lexoni faktet, duke i inkurajuar nxënësit/et të hamendësojnë speciet bimore që lidhen me secilin fakt.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- plotësimin e tabelës;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Fushata e ndërgjegjësimit mjedisor: Inkurajoni nxënësit/et të krijojnë postera ose postime në mediat sociale për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e bimëve dhe nevojën për ruajtjen e tyre.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Indet, organet dhe sistemet e organeve të bimëve	Rezultati i të nxënësve të temës (nga plani dymujor): Krahason ndërtimin e organeve vegetative (p.sh. kërcellit) të bimëve njëthelbore dhe dythelbore.		
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II.7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. III.7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënësve të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 3.17 Organet vegetative të bimëve njëthelbore dhe dythelbore			
Fjalët kyçe: rrënja, kërcelli, bimët njëthelbore, bimët dythelbore, rrënjë mitake, rrënjë boshtore, rrënjë xhufkore.			
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: - tregon ndryshimet midis kërcellit të bimëve njëthelbore dhe dythelbore; - dallon sistemin rrënjor, boshtor dhe xhufkor; - arsyeton rëndësinë e rrënjës për bimën.			
Kriteret e suksesit: - Identifiko kërcellin e bimës njëthelbore dhe dythelbore. - Përshkruaj ndërtimin e sistemit rrënjor boshtor dhe xhufkor. - Sqaro funksionin e rrënjës për bimën.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, hamer, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Imagjinatë e drejtuar Mësimdhënësi/ja paraqet para nxënësve disa bimë me një shumëllojshmëri të rrënjës dhe kërcellit. Ato shpërndahen në grupet e nxënësve.			

Gjeni bimë sezonale në oborrin tuaj ose në oborrin e shkollës (bimët njëthelbore, bime dythelbore). Kërkohet që të shënojnë në fletoren e tyre karakteristikat e këtyre bimëve, të cilat janë duke i vëzhguar.

Pyetje dhe diskutim

Mësimdhënësi/ja u tregon nxënësve që sot do të eksplorojnë llojet e ndryshe të rrënjës dhe kërcellit të bimët e ndryshme. U kërkohet nxënësve të përdorin informacionin në librin e nxënësit, për të punuar rreth dallimeve mes kërcellit dhe rrënjës të një- dhe dythelboret.

Paraqiten disa pyetje dhe nxënësit/et me ndihmën e bimëve dhe librit do të mundohen të përgjigjen.

Tregoni cila prej bimëve është bimë njëthelbore.

Cila prej bimëve ka rrënje mitake?

Sqaroni sistemin e rrënjëve boshtor dhe xhufkore.

Tregoni mënyrën e krijimit të tufave përçuese të bimët një- dhe dythelbore.

Identifikon ku ndodhen tufat përçuese të karota (karota pritet dhe u shpërndahet grupeve të nxënësve, që ta vëzhgojnë nga afër).

Nëse ndonjë nga përgjigjet e nxënësve nuk është e saktë, jepen sqarimet e duhura nga mësimdhënësi/ja.

Kllaster

Kërko nga nxënësit/et që të mbyllin librat dhe me njohuritë e fituara të shënojnë një Kllaster. Disa nga mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kërkohet nga nxënësit/et të gjejnë një bime një ose dy thelbore të zonës ku banojnë e të paraqesin dallimet midis tyre.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Lëndët ushqyese		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Shpjegon rolin dhe rëndësinë e përbërësve të ushqimit. Emërton lloje të vitaminave dhe identifikon ushqime më përbërje vitaminoze.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. V.1 Vlerëson përmbajtjen dhe vlerat ushqyese të llojeve të ushqimeve të cilat njeriu i konsumon, duke i kategorizuar ato në bazë të nevojave të individit për to në situata të ndryshme, si: gjatë stinëve, sëmundjeve etj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 4.1 Larmia e lëndëve ushqyese			
Fjalët kyçe: Proteina, karbohidrate, vitamina, mineralet.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkuan ushqimet për të cilat ka nevojë organizmi; - shpjegon rolin e mineraleve në organizëm; - sqaron mungesën e vitaminave në organizëm. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Listo lëndët ushqyese të nevojshme për njeriun. - Trego rëndësinë e mineraleve në organizëm. - Analizo nevojën e sasive të ndryshme të vitaminave. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Lapsi në mes Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit/et të shkruajnë ushqimin e tyre të preferuar. Më pas, mësimdhënësi/ja afrohet afër grupeve dhe merr njërin nga lapsat dhe e pyet të zotin e lapsit se cili është ushqimi i preferuar. Vazhdon diskutimi me pyetje rreth përbërjes së ushqimit të preferuar.			

Lexim përmbledhje në dyshe

Nxënësit/et do të punojnë në dyshe. Ndahet tekstin në paragrafë. Nxënësi/ja i parë do të lexojë paragrafin e parë dhe do të bëjë përmbledhjen e tij. Kërkohet edhe nga disa nxënës/e të tjerë të bëjnë përmbledhjen e kësaj pjese. Nëse është e nevojshme për sqarime shtesë, mund të bëhen edhe nga ana e mësimitdhënësit/et. Nxënësi/ja i dytë bën pyetje rreth këtij paragrafi. Edhe nxënësit/et e tjerë mund të bëjnë pyetje për këtë paragraf. Nxënësi/ja i parë jep përgjigjet për pyetjet. Edhe nxënësit/et e tjerë mund të japin përgjigje. Përgjigjet mund të përmirësohen edhe nga ana e mësimitdhënësit/et. Vazhdohet kështu me çdo paragraf. Mësimitdhënësi/ja kujdeset që të drejtojë pyetje drejt njësisë mësimore nëse është e nevojshme.

Tabela e koncepteve

Mësimitdhënësi/ja ka përgatitur më parë një tabelë, të cilën duhet ta plotësojnë nxënësit/et.

Lëndët ushqyese	Funksioni	Ushqimet ku ndodhen
Karbohidratet		
Proteinat		
Vitaminat		
Mineralet		
Uji		

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- krijimin e pyetjeve;
- plotësimin e tabelës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtohet rreth ushqimeve të shëndetshme për njeriun.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimitdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.


PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Ushqimet te njeriu		Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor): Shpjegon rolin dhe rëndësinë e përbërësve të ushqimit. Hulumton informacione për dietë.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): II.7 Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. III.6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 4.4 Dieta ushqimore e ekuilibruar është thelbësore për shëndetin e mirë			
Fjalët kyçe: dietë, proteina, karbohidrate, vitamina, mineralet.			
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan një dietë të ekuilibruar; - dallon makronutrientët dhe mikronutrientët; - tregon rolin e ushqimeve me përbërje proteinash në organizëm. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Jep të paktën një shembull të një diete të ekuilibruar. - Krahaso lëndët ushqyese nga sasia të cilën kërkohen. - Listo ushqimet me përbërje proteinash. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Diskutim i njohurive paraprake Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke kërkuar nga nxënësit/et që të shënojnë vaktet me të cilat janë ushqyer ditën e djeshme. Më pas, diskutohet rreth tyre me nxënësit/et. Idetë dhe mendimet e nxënësve shënohen në tabelë.			

Lexim i drejtuar

Njësia mësimore ndahet në paragrafë dhe para leximit të çdo paragrafi kërkohet nga nxënësit/et të bëjnë një parashikim. Që t’iu vijë në ndihmë nxënësve, mësimdhënësi/ja paraqet foto para nxënësve. Ata/ato fillojnë dhe diskutojnë për foton. Më pas, kërkohet që të lexohet paragrafi i parë i njësisë mësimore dhe të diskutojnë atë me parashikimet e tyre. E njëjta procedurë vazhdohet edhe me paragrafin tjetër të njësisë mësimore. Ndërkohë gjatë diskutimit të nxënësve, mësimdhënësi/ja ndërhyr nëse është e nevojshme me sqarimet te termave kyç të njësisë mësimore.



Diskutojmë së bashku

Në fund të orës mësimore kërkohet nga nxënësit/et t’u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme dhe të plotësojnë të dhënat e shënuara në fillim të orës mësimore.

Çfarë është një dietë e ekuilibruar?

Cilat lëndë ushqyese përfshihen te makronutrientët dhe cilat te mikronutrientët?

Përse perimet duhet të zënë 1/3 e regjimit ushqimor ditor?

Cilat produkte ushqimore janë burim i proteinave, po i vitaminave?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- krijimin e pyetjeve;
- plotësimin e tabelës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Hartoni një dietë të ekuilibruar për organizmin tuaj.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Ushqimet te njeriu		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Shpjegon pasojat e ushqyeshmërisë jo të rregullt. Identifikon dhe shpjegon për ushqimet jo të shëndetshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6 Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore. II.7 Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. V.3 Vlerëson domosdoshmërinë e kushteve të mira higjienike për përgatitjen dhe konsumimin e ushqimeve dhe pijeve dhe shpjegon rrethanat e mundshme të helmimit nga ushqimet dhe papastërtia.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Shpjegon rolin e karbohidrateve, mineraleve, lipideve, proteinave, vitaminave, ujit dhe fibrave për dietë të shëndetshme dhe llogaritë nevojën ditore për energji nga ushqimet e konsumuara.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim Njësia mësimore: 4.5 Pasojat e të ushqyerit të pashëndetshëm			
Fjalët kyçe: dietë, kequshqyerje, ushqime, shëndet.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan një dietë të pashëndetshme; - shpjegoni se si ushqimi ndikon në shëndetin e njeriut; - identifikoni ndikimet kryesore në zgjedhjen e ushqimit. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Listo ushqimet e pashëndetshme. - Analizo pasojat e kequshqyerjes. - Jep shembuj specifikë për secilin. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Imagjinatë e drejtuar

Orën mësimore, mësimdhënësi/ja e fillon duke paraqitur fotot e mëposhtme para nxënësve.

Kërkon prej tyre të komentojnë atë që shohin.



Lexim dhe pyetje

Pas diskutimit me nxënës/e, mësimdhënësi/ja vazhdon me disa pyetje:

A do të ishte e shëndetshme nëse do të haja si ushqim vetëm fruta dhe perime?

A do të ishte e shëndetshme nëse do të haja gjithmonë një ushqim të veçantë nga secili grup, p.sh. bizele, kos, karamele? (Jo, theksoni ekuilibrin dhe shumëllojshmërinë).

Cilat janë pasojat e ushqimit jo të shëndetshëm?

Për të gjetur përgjigjet e duhura, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit/et që të lexojnë njësinë mësimore.

Ndahet njësia mësimore në paragrafë. Nxënësit/et ndahen në dyshe, lexojnë së bashku paragrafin, si dhe shënojnë termat kryesorë të asaj pjese në fletore. Njëri prej nxënësve shënon pyetje në fletore duke përfshirë termat e përcaktuar më herët. Më pas, i shkëmbejnë fletoret me shokun e bankës, duke u përgjigjur pyetjeve. Vazhdohet kështu edhe me pjesën tjetër të njësisë mësimore. Mësimdhënësi/ja vëzhgon punën e nxënësve, si dhe jep sqarim nëse e sheh të nevojshme.

Shkrim i shpejtë

Kërkohet nga nxënësit/et të shënojnë rreth temës së mësuar. Lexohen punimet e tyre dhe më pas komentojnë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- pjesëmarrje aktive në diskutim;
- përgjigjet e sakta;
- ide dhe mendime të argumentuara.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Argumentoni thënien “Mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë”.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMOR

Zgjedhja e mësimdhënësit/et sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Shëndeti sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënës të temës (nga plani dymujor): Shpjegon ndërtimin dhe funksionin e organeve riprodhuese dhe kupton proceset si menstruacioni, spermatogjenezën, ovulimin dhe fertilizimin.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): I.6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore III.7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënës të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 5.2 Sistemi riprodhues të njeriut			
Fjalët kyçe: gamete, spermatozoide, qeliza veze, testikujt, vezoret, tubat e fallopit, riprodhim.			
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan ndërtimin e organit riprodhues të meshkujt; - përshkruan ndërtimin e organit riprodhues të femrat; - përshkruan mënyrën e formimit të spermatozoideve. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Shpjego funksionin e pjesëve ndërtuese të organeve riprodhuese mashkullore. - Shpjego funksionin e pjesëve ndërtuese të organeve riprodhuese mashkullore. - Analizo mënyrën e formimit të spermatozoideve. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			
Pyetja sjell pyetjen Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore me pyetje rreth sistemit riprodhues të njeriut. Sistemet riprodhuese të meshkujve dhe femrave përbëhen nga organe të jashtme dhe të brendshme. Pyetni nxënësit/et se çfarë funksioni ka sistemi riprodhues në trupin tonë. Cilat janë karakteristikat e riprodhimit të njeriut?			

Tabela e koncepteve

Kërkohet nga nxënësit/et që të lexojnë njësinë mësimore dhe të plotësojnë tabelën e dhënë.

Në çdo kolonë shënohen pjesët e organeve, të cilat ndodhen te gjinitë e ndryshme si dhe jepen sqarimet për to.

Femër	Mashkull
Vezoret- prodhohen qelizat veze	Testikuj - prodhohen spermatozoidet
Tubat e fallopit	Prostatë
Vagina	Skrotumi
Uterusi	

Rrjeti i diskutimit

Pasi nxënësit/et të kenë plotësuar tabelën, ata/ato ftohen të diskutojnë punën e tyre. Nëse gjatë diskutimit vërehen pasaktësi atëherë jep sqarimet e duhura mësimdhënësi/ja.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Kërkohet nga nxënësit/et të ndërtojnë një model të organeve riprodhuese të njeriut.

Ata mund të përdorin çfarëdo materiali që preferojnë, qoftë baltë, letër, pastrues tubash, ngjitës apo çfarëdo që ata duan.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkenca e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Shëndeti sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Përshkruan metodat tradicionale dhe moderne kontraceptive.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.8. Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore. IV.1 Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme. V.8. Përshkruan mundësitë, rreziqet dhe pasojat e infeksioneve dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe sqaron mënyrat dhe mjetet për parandalimin e tyre, duke përdorur forma të ndryshme të prezantimit (të folur, të shkruar, grafike, pllakate, pamflete, lojë teatrale, performancë artistike etj.).			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 5.3 Shëndeti riprodhues përfshin kontracëpsionin dhe sëmundjet			
Fjalët kyçe: kontracëpsion, pilula, metoda, prezervativë, sëmundje seksualisht të transmetueshme.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan cilat janë metodat kontraceptive; - sqaron qëllimet e përdorimit të prezervativëve; - identifikon disa sëmundje seksualisht të transmetueshme. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Dallo llojet e metodave kontraceptive. - Analizo funksionin e prezervativëve. - Përshkruaj së paku tri sëmundje seksualisht të transmetueshme. 			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, slajde për prezantim.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE
Stuhi mendimesh
Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit/et se për cilat nga metodat kontraceptive kanë dëgjuar. Më pas, nxënësit/et shprehin të gjitha mendimet, pa i komentuar. Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë. Pas tyre, mësimdhënësi/ja fillon dhe i komenton ato.
Pyetje-përgjigje
Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit/et që të punojnë në çifte. Njësia mësimore ndahet në dy paragrafë (paragrafi 1 dhe 2). U përcaktohet çifteve nga një numër, numri një dhe dy. Nxënësi/ja me numrin një, do të krijojë tri pyetje për paragrafin dy, ndërsa nxënësi/ja me numrin dy, do të krijojë tri pyetje për paragrafin e parë. Për të krijuar pyetje si dhe për t'u përgjigjur sa më mirë, nxënësit/et udhëzohen të hapin librat dhe të lexojnë njësinë mësimore.
Secili prej çifteve del para klasës dhe lexojnë pyetjet e përgjigjet e tyre. Mësimdhënësi/ja sqaron pjesët që verën që janë të paqarta për nxënësit/et.
Diskutim
Mësimdhënësi/ja hap diskutimin me pyetjen: Cilat janë qëllimet e përdorimit të prezervativëve?
VLERËSIMI I NXËNËSVE
Nxënësit/et vlerësohen për:
<ul style="list-style-type: none"> - përgjigjet e sakta; - pjesëmarrjen në diskutim.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Të hulumtohet rreth sëmundjeve seksualisht të transmetueshme.
REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE
Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Mësimdhënësi/ja:

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës	Lënda: Biologji	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VII
Tema (nga plani dymujor): Shëndeti sjelljet dhe emocionet e njeriut		Rezultati i të nxënit të temës (nga plani dymujor): Diskuton ndikimin e alkoolit dhe drogave në sjelljen e vendimeve të përgjegjshme. Kupton rëndësinë, mënyrat e vetëkontrollit të trupit dhe di ku duhet të drejtohet për të marrë këshilla dhe ndihmë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.8. Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore. IV.2. Ndërmerr aktivitete të ndryshme (ekspozitë, performancë, instilacion, fushatë, protestë paqësore, tubim, avokim etj.) në bazë të projektit, të hartuar me anëtarët e grupit, për zgjidhjen e një problemi me rëndësi shoqërore, për shkollën ose për komunitetin. V.9. Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo drogës) etj.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): Dallon dhe krahason ndërtimin dhe funksionin e qelizës, indeve, organeve dhe sistemeve të organeve, duke u referuar biodiversitetit të qenieve të gjalla, shkaktarët e sëmundjeve të njeriut, shtazët bimët dhe mënyrat e kontrollit të tyre, metabolizmin, zhvillimin individual të njeriut dhe evolucionin e qenieve të gjalla.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Tipi i orës: Zhvillim			
Njësia mësimore: 5.4 Ndikimi i alkoolit dhe drogave në shëndetin e njeriut			
Fjalët kyçe: alkool, droge, pasoja, trajtim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan pasojat e përdorimit të alkoolit; - sqaron dëmet e organizmit nga përdorimi i drogës; - identifikon mënyrat e trajtimit të varësisë nga droga. 			
Kriteret e suksesit: <ul style="list-style-type: none"> - Trego çfarë ndodh me organizmin nga konsumimi i alkoolit. - Analizo dëmtimet e sistemi nervor nga drogat. - Jep shembuj të trajtimit të varësisë nga droga. 			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri Biologjia 8, fotografi, projektor, hamer, slajde për prezantim.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë dhe komunikim, Shkencat natyrore: Kimi, TIK			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS MË NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE			

Imagjinatë e drejtuar

Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore duke shfaqur disa foto të ndikimit të alkoolit dhe drogave në trupin e njeriut. Kërkohet nga nxënësit/et t'i shikojnë me vëmendje fotot dhe të reflektojnë rreth tyre.

Loja me role

Mësimdhënësi/ja ndan klasën në grupe. Kërkon prej tyre që të lexojnë njësinë mësimore dhe të përgatisin një fushatë vetëdijesuese kundër përdorimit të drogës dhe alkoolit. Për përgatitjen e fushatës, ata/ato do të përdorin ngjyra, hamer, foto për të cilat janë lajmëruar një ditë më parë. Ata/ato do të paramendojnë që do të prezantojnë para një ekipi televiziv, i cila do të bëjë përzgjedhjen e grupit fitues. Grupi fitues do të jetë ai grup që do të bindë ekipin televiziv ta shfaqë fushatën e tyre në media. Pjesëtarët e grupit televiziv do të jenë përfaqësues të secilit grup të nxënësve. Pas prezantimeve të nxënësve, anëtarët e grupit televiziv bëjnë pyetje.

Diskutimi

Nxënësit/et vazhdojnë diskutimin rreth arsyeve se pse njerëzit pinë cigare, drogë dhe alkool dhe pse jo.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit/et vlerësohen për:

- përgjigjet e sakta;
- pjesëmarrjen në diskutim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Të hulumtohet rreth dëmtimeve të sistemit nervor nga droga dhe alkooli.

REFLEKTIMI PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

Zgjedhja e mësimdhënësit/es sa i përket rrjedhës së orës mësimore.

REFERENCA

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë 2016

Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës, gusht 2016

Kurrikulat lëndore/programet mësimore për lëndën Biologji 8, Prishtinë, Kosovë

Standarde për tekstet shkollore Prishtinë, 2011

Burime nga interneti

<https://www.dreamstime.com/>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:57(072)(075.2)

Duraku, Klementina

Liber për mësuesin/en Biologjia 8 / Klementina Duraku,
Albina Skica. - Prishtinë : Pegi, 2025. - 105 f. : ilustr. ; 26
cm.

1. Skica, Albina

ISBN 978-9951-843-56-0